

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

1. Veprimtari të tjera, ID 12.3, “Institucionet shendetesore”.

(Veprimtari të tjera; 12.3, sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)



SUBJEKTI: *“Intermedica Center” Sh.p.k*

NIPT: K31513084W

VENDNDODHJA: Rruga “Kongresi i Manastirit”, pallati Nr.48, Tiranë.

Tirane 2021

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Subjekti "**Intermedica Center**" Sh.p.k kryen aktivitetin "**Institucionet shendetesore**".

Per kete aktivitet ky subjekt eshte pajisur me Leje Mjedisi Tipi C me **Nr.identifikimi 65, Nr. Prot 65 dhe date 20. 03. 2018** per "Veprimtari te tjera. Ambulanca, spitale ditore pa shtreter, poliklinike dentare me mbi 3 poltrona, laboratore mjeksor dhe dentare". *Bazuar Ligjit 52/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar"*, ky subjekt kerkon te pajiset me Leje tipi B per aktivitetin ne fjale.

Laboratori INTERMEDICA përdor teknologjinë dhe metodat më të fundit. Në Intermedica janë instaluar pajisje dhe analizatorë të kompanive Roche, Sysmex dhe Euroimmun, disa nga kompanitë më të njohura në fushën e ekzaminimeve laboratorike. Intermedica ka qenë e para qendër diagnostike që ka instaluar në Shqipëri Modular Cobas 6000, Cobas TaqMan 48 PCR, Cobas E411, Integra 400, Stago Compact, Sebia Capillary Electrophoresis, Cobas U411 dhe Sysmex XS-1000i dhe XN-550, VITEK 2 Compact dhe Sysmex UN – Urineanalysis series (UF 4000 / UC 3500) dhe EUROBlotOne. Këto pajisje monitorohen online 24 orë në 7 ditë të javës. Ndjekja e të gjitha proceseve laboratorike kryhet me sistemin barcode LIS-PSM, i instaluar për herë të parë në Shqipëri vetëm në laboratorin Intermedica. Ky sistem i cakton çdo pacienti një bar kod unik, të pandryshueshëm gjatë gjithë proceseve ekzaminuese.


Te gjitha ekzaminimet kryhen nga nje staf mjeko-laborante te certifikuar i specializuar dhe me nje pervoje disa vjecare. Ne vend te metodave te zakonshne dhe klasike te trajtimit , pacientet iu nenshtrohen trajtimit vetjak ,qe percaktohet ne baze te rezultateve te nje sere analizash te hollesishme te kryera nga specialistet e laboratorit.

Metodat me te reja laboratorike te intermedica:

- Electrochemiluminescenca (ECL)
- ELISA
- IMMUNOBLLOT
- PCR – REAL TIME

2. VENDODHJA E AKTIVITETIT

Subjekti "**Intermedica Center**" Sh.p.k kryen aktivitetin **ID 12.3 "Institucionet shendetesore"**. Vendodhja e aktivitetit eshte **Rruga "Kongresi i Manastirit", pallati Nr.48, Tiranë**.



Kordinatat e Gaus Kruger

X	Y
4402690.117	4579008.378

3. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

-Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

-Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

Sapo hyn ne objekt ndodhet salla kryesore e pritjes , recepsioni i disponueshem ne cdo moment te shpalljes te orarit te punes , nje ambjnet i paster , shume i sistemuar per qellimin e ketij aktiviteti dhe ka literature informuese qe i dhurohet falas klienteve per nje higjene dhe nje shendet sa me te sigurt.

Pas kontaktit te pare me kilentin ne varesi te sherbimit qe kerkon, kalon permes korridorit nga drejtimi per ne ambjentin qe eshte i lire per diagnostikim e pas per kryerjen e analizave . Ambjentet jane te ndara, te ndertuara ne menyre bashkekohore, te pajisur me aparaturat e nevojshem per kete Iloj sherbimi, e mbrojtur teresisht nga ndonje shkarkim i mundshem energji e me garanci shume te larte si per jeten e kilentit ashtu edhe te mjekut qe punon ne keto pajisje.

Steriliteti eshte mjaft i larte duke perdorur masa mbrojtese si tek duart e mjekut dhe maska ne frymemarrje. Personeli eshte i kualifikuar, me nje pervoje pune te gjate, duke ndikuar ne rritjen e frekuentimit te ketij laboratorit dhe per pasoje edhe rritjen e shkalles se ndikimit per nje kujdes shume te madh ne kete Iloj sherbimi. Shumica e veglave diagnostikuese, pavaresisht sterilitetit te larte dhe shume te kujdesshem jane njeperdorimshme duke ndihmuar keshtu ne bllokimin maksimal te semundjeve infektive te transmetueshme nga perdorimi jo i mire veglave diagnostikuese.

Cdo ambjent i vecante pune , funksionon ne menyre te pavarur nga njeri -tjetrin ne varesi te pacienteve frekuentues por mund te punojne edhe njekohesisht ne pavaresi te plote me njeri — tjerin dhe secili ambjent i ka te gjitha mjetet e nevojshme , te gjitha veglat dhe cka eshte e nevojshme per kete aktivitet pa i nderthurur dhe ne pavaresi me njeri — tjetrin.

Te gjitha ambjentet perberese jane shume te pastra, komode, te pajisura me aparatura moderne, te kohes, me nje personel teper te kualifikuar dhe nje disipline shume e madhe duke filluar qe nga hyrja ne objekt, qendrimi ne pritje te vizitave apo diagnostikimeve, kurimi dhe ne te gjitha ambjentet, si dhe ne trajtimin e mbetjeve i cili behet ditor, ne cast dhe ne cdo moment duke evituar cdo pasoje qe vjen nga depozitimi i perkoheshem i tyre, nga ererat e keqija etj. Në kete laborator me personel te kualifikuar perdoret teknologjia bashkohore e kimise klinike per realializimin e një game shume te gjere te analizave biokimike dhe hormonale.

- Burimet e shkarkimeve nga instalimi;

Shkarkimet ne ajer – Referuar natyres se sherbimeve qe subjekti ofron, nuk kemi sasi gazrash te shkarkuara ne atmosfere, pasi ne kete aktivitet nuk ka asnje pajisje qe mund te shkaktoje ndotje te ajrit. Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk ka emetime te ndryshme kimike, te cfaredo lloji qofshin ato.

Shkarkime ne uje – Nga ushtrimi I ketij aktiviteti ne kushte optimale, nuk kemi shkarkime me karakter ndotes ne uje duke perfshire ketu ujrat siperfaqesore, nentokesore dhe kanalizimet. Ne kanalizime do te shkarkohen vetem ujrat higjenu – sanitare, te cilat nuk mbarin komponente qe mund te ndikojne ne cilesine e ujrave.

Shkarkime ne toke – Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete shkarkime ne toke.

Zhurma - Per nga vete natyra e aktivitetit qe zhvillon subjekti, nuk konstatohen gjenerime te zhurmes. Te vetmet burime te zhurmes, mund te cilesiojme ato nga bisedat mes mjekeve dhe pacienteve, te cilat jane ne nivele minimale.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERSIMIT I NDIKIMEVE NE MJEDIS

- Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve negative ne mjedis

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja me projektin dhe sherbimet qe ai ofron.
- Nohja me paisjet dhe aparaturat qe sherbejne per kryerjen e ketyre sherbimeve.

- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe vendit ku ndodhet klinika.
- Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojen per infrastrukture te re per projektin.
- Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zbatimin e projektit.

Masat për zbutjen e ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës se kryerjes se proceseve te punes se INTERMEDICA CENTER dhe Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative:

- Evadimi i mbetjeve urbane sipas legjiskacionit ne fuqi.
- Evadimi i mbetjeve spitalore sipas kontrates bashkengjitur.
- Te kryej auditim te vazhdueshem te energjise me ekspert te licensuar.
- Te kryej zevendesimet e paisjeve jo me vone se 2 vjet.
- Te mirembaje ne menyre te vazhdueshme paisjet qe perdoren per ofrimin e sherbimeve.
- Te kete vemendjen maksimale ndaj kushteve higjeno-sanitare.
- Te kryej inspektime te perditshme per kushtet higjeno-sanitare dhe per kushtet e punes se punonjesve pasi kemi te bejm me nje aktivitet shendetesor dhe per vet llojin e aktivitetit ambjentet e tij duhet te jene gjithone te pastra e te disinfektuara.

“Intermedica Center” sh.p.k

Administrator

Vasil Llajo